



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/64  
Datë: 25.02.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shkurt 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, vendosë sanksione në përputhje me sanksionet e vendosura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Rregullores së Këshillit (EU) Nr.269/2014 të datës 17 mars 2014, të amendamentuar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr. 2022/259, dhe të zgjeruar me Rregulloret Zbatuese të Këshillit Nr.2022/260, Nr.2022/261, të datës 23.02.2022, respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP të datës 17 mars 2014 të amendamentuar me Vendimet e Këshillit (CFSP) 2022/241; (CFSP) 2022/265; (CFSP) 2022/267, lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.
2. Sanksionet konsistojnë në:
  - 2.1. Ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës të individëve apo entiteteve të sanksionuara;
  - 2.2. Ndalim udhëtimi në territorin e Republikës së Kosovës për individët e sanksionuar;
  - 2.3. Ndalim për individë dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara.
3. Emrat e individëve dhe entiteteve të sanksionuara janë ato listuara në anekset e akteve rregullative të Këshillit të Bashkimit Evropian referuar në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Sanksionet do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

LISTA E INDIVIDËVE DHE ENTITETEVE TË SANKSIONUAR NGA QEVERIA E RKS-SË

sipas

Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014 të datës 17 mars 2014, amandamentuar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr. 2022/259, dhe zgjeruar me Rregulloret Zbatuese të Këshillit Nr. 2022/260, Nr. 2022/261, të datës 23.02.2022, respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP të datës 17 mars 2014 amandamentuar me Vendimet e Këshillit (CFSP) 2022/241; (CFSP) 2022/265; (CFSP) 2022/267

lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.

## INDIVIDËT

Nr	Emri	Informacioni identifikues	Arsyeja	Data e listimit
1	Sergey Valeryevich AKSYONOV Sergei Valerievich AKSENOV (Сергей Валерьевич АКСЕНОВ) Serhiy Valeriyovych AKSYONOV (Сергій Валерійович АКСЬОНОВ)	Gjinia:Mashkull Data e Lindjes: 26.11.1972 Vendi i lindjes: Beltsy (Bălți), RSS e Moldavisë (tani Republika e Moldavisë)	Aksyonov u zgjodh ‘Kryeministër i Krimesë’ në Verkhovna Rada të Krimesë më 27 shkurt 2014 në prani të personave të armatosur pro-rusë. ‘Zgjedhja’ e tij u dekretua në mënyre jokushtetuese nga presidenti në detyrë i Ukrainës Oleksandr Turchynov më 1 mars 2014. Ai lloboi në mënyrë aktive për ‘referendumin’ e datës 16 mars 2014 dhe ishte një nga bashkëenëshkruesit e ‘traktatit për pranimin e Krimesë në Federatën Ruse’ më 18 mars 2014. Më 9 prill 2014, ai u emërua ushtrues detyre i ‘Kryetarit’ të të ashtuquajturës ‘Republika e Krimesë’ nga Presidenti Putin. Më 9 tetor 2014, ai u ‘zgjodh’ zyrtarisht ‘Kryetar’ i të ashtuquajturës ‘Republika e Krimesë’. Në shtator të vitit 2019, ai ‘ri-zgjidhet’ në këtë post. Anëtar i Këshillit Shtetëror të Ruisë. Që nga janari i vitit 2017, ai është anëtar i Këshillit të Lartë të Partisë Rusia e Bashkuar. Për përfshirjen e tij në procesin e aneksimit është vlerësuar me Urdhrin Shtetëror Rus ‘Për meritë ndaj	17.03.2014

			atdheut' - shkalla e parë.	
2	Vladimir Andreevich KONSTANTINOV (Владимир Андреевич КОНСТАНТИНОВ) Volodymyr Andriyovych KONSTANTINOV (Володимир Андрійович КОНСТАНТИНОВ)	Gjinia: Mashkull Data e lindjes: 19.11.1956 Vendi i lindjes: Vladimirovka (a.k.a. Vladimirovca), Rajoni Slobozia, RSS e Moldavisë (tani Republika e Moldavisë) ose Bogomol, RSS e Moldavisë (tani Republika e Moldavisë)	Si kryetar i Këshillit Suprem të 'Republikës autonome të Krimesë', Konstantinov luajti një rol të rëndësishëm në vendimet e marra nga 'Këshilli Suprem' në lidhje me 'referendumin' kundër integritetit territorial të Ukrainës dhe u bëri thirrje votuesve të japin votat e tyre në favor të pavarësisë së Krimesë në 'referendumin' e datës 16 mars 2014. Ai ishte një nga bashkëpunuesit e 'traktatit për pranimin e Krimesë në Federatën Ruse' më 18 mars 2014. Që nga data 17 mars 2014, 'Kryetar' i 'Këshillit të Shtetit' të të ashtuquajturës 'Republika e Krimesë'. Ai 'ri-zgjedhet' në këtë detyrë në shtator të vitit 2019.	17.03.2014
3	Rustam Ilmirovich TEMIRGALIEV (Рустам Ильмирович ТЕМИ-РГАЛИЕВ) Rustam Ilmyrovych TEMIRHALIEV (Рустам Ильмирович ТЕМИРГАЛІЄВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 15.8.1976 Vendi i lindjes: Ulan-Ude, RSS Autonome Buryat (Republika Socialiste Federative Sovjetike Ruse) (tani Federata Ruse)	Si ish-zëvendëskryeministër i Krimesë, Temirgaliev luajti një rol të rëndësishëm në vendimet e marra nga 'Këshilli Suprem' në lidhje me 'referendumin' e datës 16 mars 2014 kundër integritetit territorial të Ukrainës. Ai lloboi aktivisht për integrimin e Krimesë në Federatën Ruse. Më 11 qershor 2014, ai dha dorëheqjen nga funksioni i tij si 'Zëvendëskryeministër i parë' i të ashtuquajturës 'Republika e Krimesë'. Aktualisht, ai është Drejtor i Përgjithshëm i Kompanisë Menaxhuese të Fondit të Investimeve Ruso-Kineze për Zhvillimin Rajonal. Mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste.	17.03.2014
4	Denis Valentinovich BEREZOVSKIY (Денис Валентинович БЕРЕЗОВСКИЙ) Denys Valentynovych BEREZOVSKYY (Денис Валентинович БЕРЕЗОВСЬКИЙ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes 15.7.1974 Vendi i lindjes: Kharkiv, RSS e Ukrainës (tani Ukraina)	Berezovskiy u emërua komandant i Marinës së Ukrainës më 1 mars 2014, por më pas u betua për forcat e armatosura të Krimesë, duke thyer kështu betimin e tij ndaj Marinës së Ukrainës. Ai ishte Zëvendës Komandant i Flotës së Detit të Zi të Federatës Ruse deri në tetor të vitit 2015. Ai është Ushtrues detyre i Komandantit të Flotës së Paqësorit të Federatës Ruse dhe Zëvendës Admiral.	17.03.2014

5	<p>Aleksei Mikhailovich CHALIY (Алексей Михайлович ЧАЛЫЙ) Oleksiy Mykhaylovych CHALYY (Олексій Михайлович ЧАЛИЙ)</p>	<p>Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 13.6.1961 Vendi i lindjes: Moskë, Federata Ruse ose Sevastopol, Ukrainë</p>	<p>Chaliy u bë 'Kryetari Popullor i Sevastopolit' me brohoritje popullore më 23 shkurt 2014 dhe e pranoi këtë 'votim'. Ai bëri fushatë aktive që Sevastopoli të bëhej një entitet i veçantë i Federatës Ruse, pas një referendumi më 16 mars 2014. Ai ishte një nga bashkëenëshkruesit e 'traktatit për pranimin e Krimesë në Federatën Ruse' më 18 mars 2014. Ai ishte ushtrues detyre i 'gubernatorit' të Sevastopolit nga data 1 deri më 14 prill 2014 dhe është ish-kryetar 'i zgjedhur' i 'Asamblesë Legjislative' të qytetit të Sevastopolit. Ish-anëtar i 'Asamblesë Legjislative' të qytetit të Sevastopolit (deri në shtator të vitit 2019). Mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste. Për përfshirjen e tij në procesin e aneksimit, ai është vlerësuar me Urdhrin Shtetëror Rus 'Për Merita ndaj Atdheut' - shkalla e parë. Ai është menaxher i përgjithshëm i Smart Electric Networks LLC (ООО 'РѕєСсјѢх ЁоxкѳѳѦхРѡхРѡѦх РѡѦѦ').</p>	17.03.2014
6	<p>Pyotr Anatoliyovych ЗИМА (Пётр Анатольевич ЗИМА) Petro Anatoliyovych ЗУМА (Петро Анатолійович ЗИМА)</p>	<p>Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 18.1.1970 ose 29.3.1965 Vendi i lindjes: Artemivsk (Артемівск) (2016 i riemëruar në Bakhmut/Бахмут), Donetsk Oblast, Ukrainë</p>	<p>Zima u emërua si kreu i ri i Shërbimit të Sigurisë së Krimesë (SBU) më 3 mars 2014 nga 'kryeministri' Aksyonov dhe e pranoi këtë emërim. Ai ka dhënë informacione përkatëse, duke përfshirë një bazë të dhënash për Shërbimin Informativ Rus (FSB). Kjo përfshinte informacione për aktivistët e Euro-Maidan dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut të Krimesë. Ai luajti një rol të rëndësishëm në parandalimin e autoriteteve të Ukrainës për të kontrolluar territorin e Krimesë. Më 11 mars 2014, u shpall formimi i një Shërbimi të pavarur të Sigurisë së Krimesë nga ish-oficerët e SBU të Krimesë. Ai është aktiv që nga viti 2015 në Shërbimin e Inteligjencës Ruse (FSB).</p>	17.03.2014
7	<p>VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2016/359 datë 10 mars 2016</p>		<p>Personat e mëposhtëm janë fshirë nga lista e përcaktuar në Shtojcën e Vendimit 2014/145/CFSP</p>	
8	<p>Sergey Pavlovych</p>	<p>Gjinia: Mashkull</p>	<p>Si zëvendëskryetar i Verkhovna Rada të</p>	17.03.2014

	<p>TSEKOV (Сергей Павлович ЦЕКОВ) Serhiy Pavlovych TSEKOV (Сергій Павлович ЦЕКОВ)</p>	<p>Data e Lindjes: 28.9.1953 ose 28.8.1953 Vendi i lindjes: Simferopol, Ukrainë</p>	<p>Krimesë, Tsekov inicioi, së bashku me Sergej Aksyonov, shkarkimin e paligjshëm të qeverisë së 'Republikës Autonome të Krimesë' (ARC). Ai e tërhoqi Vladimir Konstantinovin në këtë përpjekje, duke e kërcënuar me shkarkim. Ai e pranoi publikisht se deputetët nga Krimea ishin iniciatorët e ftesës së ushtarëve rusë për të marrë kontrollin e Verkhovna Rada të Krimesë. Ai ishte një nga udhëheqësit e parë të Krimesë që kërkoi në publik aneksimin e Krimesë në Rusi. Anëtar i Këshillit Federativ të Federatës Ruse nga e ashtuquajtura 'Republika e Krimesë' që nga viti 2014, i riemëruar në shtator të vitit 2019.</p>	
9	<p>Viktor Alekseevich OZEROV (Виктор Алексеевич ОЗЕРОВ)</p>	<p>Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 5.1.1958 Vendi i lindjes: Abakan, Khakassia, Federata Ruse</p>	<p>Ish-kryetar i Komitetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Këshillit të Federatës të Federatës Ruse. Më 1 mars 2014, Ozerov, në emër të Komitetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes të Këshillit të Federatës, mbështeti publikisht, në Këshillin e Federatës, vendosjen e forcave ruse në Ukrainë. Në korrik të vitit 2017, ai dha dorëheqjen si Kryetar i Komisionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Ai vazhdoi të jetë anëtar i Këshillit dhe anëtar i Komisionit për rregullore të brendshme dhe çështje parlamentare. Më 10 tetor 2017, me një dekret N 372-SF, Ozerov u përfshi në komisionin e përkohshëm të Këshillit të Federatës për mbrojtjen e sovranitetit shtetëror dhe parandalimin e ndërhyrjeve në punët e brendshme të Federatës Ruse. Mandati i tij në Këshillin e Federatës përfundoi në shtator të vitit 2019. Që nga tetori i vitit 2019, ai është Konsulent i Fondacionit Rospolitika.</p>	17.03.2014
10	<p>Vladimir Michailovich DZHABAROV (Владимир Михайлович ДЖАБАРОВ)</p>	<p>Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 29.9.1952 Vendi i lindjes: Samarkand, Uzbekistan</p>	<p>Zëvendëskryetari i Parë i Komitetit të Çështjeve Ndërkombëtare të Këshillit të Federatës së Federatës Ruse. Më 1 mars 2014, Dzhabarov, në emër të Komitetit të Çështjeve Ndërkombëtare të Këshillit të Federatës, mbështeti publikisht, në Këshillin e Federatës, vendosjen e forcave ruse në Ukrainë.</p>	17.03.2014
11	<p>Andrei Aleks-</p>	<p>Gjinia: Mashkull</p>	<p>Kryetar i Komitetit për të Drejtën Kushtetuese</p>	17.03.2014

	androvich KLISHAS (Андрей Алек- сандрович КЛИШАС)	Data e Lindjes: 9.11.1972 Vendi i lindjes: Sverdlovsk (Ekaterinburg), Federata Ruse	dhe shtetndërtim të Këshillit të Federatës së Federatës Ruse. Më 1 mars 2014, Klishas mbështeti publikisht, në Këshillin e Federatës, vendosjen e forcave ruse në Ukrainë. Në deklaratat publike, Klishas u përpoq të justifikonte një ndërhyrje ushtarake ruse në Ukrainë duke pretenduar se 'Presidenti ukrainas mbështet apelin e autoriteteve të Krimesë drejtuar Presidentit të Federatës Ruse për marrjen e një ndihme gjithëpërfshirëse në mbrojtje të qytetarëve të Krimesë'.	
12	Nikolai Ivanovich RYZHKOV (Николай Иванович РЫЖКОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 28.9.1929 Vendi i lindjes: Dyleevka, rajoni Donetsk, RSS e Ukrainës, tani Ukraina	Anëtar i Komitetit për çështje federale, politikë rajonale dhe veri të Këshillit të Federatës së Federatës Ruse. Më 1 mars 2014, Ryzhkov mbështeti publikisht, në Këshillin e Federatës, vendosjen e forcave ruse në Ukrainë. Për përfshirjen e tij në procesin e aneksimit, në vitin 2014 është nderuar me Urdhrin Shtetëror Rus 'Për Merita ndaj Atdheut' - shkalla e parë.	17.03.2014
13 ▼M33	VENDIMI I KËSHILLIT(CFSP) 2020/399 datë 13 mars 2020		Personat e mëposhtëm janë fshirë nga lista e përcaktuar në Shtojcën e Vendimit 2014/145/CFSP	
14	Aleksandr Borisovich TOTOONOV (Александр Борисович ТОТООНОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 3.4.1957 Vendi i lindjes: Ordzhonikidze (Vladikavkaz), Osetia Veriore, Federata Ruse	Ish-anëtar i Komitetit të Çështjeve Ndërkombëtare të Këshillit të Federatës së Federatës Ruse. Detyrat e tij si anëtar i Këshillit të Federatës Ruse përfunduan në shtator të vitit 2017. Që nga shtatori i vitit 2017, ai është zëvendëskryetar i parë i Parlamentit të Osetisë së Veriut. Më 1 mars 2014, Totoonov mbështeti publikisht, në Këshillin e Federatës, vendosjen e forcave ruse në Ukrainë.	17.03.2014
15	VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2017/1561 datë 14 shtator 2017		Personat e mëposhtëm janë fshirë nga lista e përcaktuar në Shtojcën e Vendimit 2014/145/CFSP	17.03.2014
16	Sergei Mikhailovich MIRONOV (Сергей Михайлович МИРОНОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 14.2.1953 Vendi i lindjes: Pushkin, Rajoni i	Anëtar i Këshillit të Dumës Shtetërore; Udhëheqësi i fraksionit 'Rusia e drejtë' në Dumën e Shtetit të Federatës Ruse. Nismëtari i projektligjit që lejon Federatën Ruse të pranojë në përbërjen e saj, nën pretekstin e mbrojtjes së	17.03.2014

		Leningradit, Federata Ruse	qytetarëve rusë, territore të një vendi të huaj pa pëlqimin e atij vendi ose një traktati ndërkombëtar.	
17	Sergei Vladimirovich ZHELEZNYAK (Сергей Владимирович ЖЕЛЕЗНЯК)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 30.7.1970 Vendi i lindjes: Shën Petersburg (ish Leningrad), Federata Ruse	Ish Nënkryetari i Dumës Shtetërore të Federatës Ruse. Mbështeti në mënyrë aktive përdorimin e Forcave të Armatosura Ruse në Ukrainë dhe aneksimin e Krimesë. Ai drejtoi personalisht demonstratën në mbështetje të përdorimit të Forcave të Armatosura Ruse në Ukrainë. Ish nënkryetar dhe aktualisht anëtar i Komitetit të Punëve të Jashtme të Dumës Shtetërore të Federatës Ruse. Anëtar i Presidiumit të Këshillit të Përgjithshëm të partisë Rusia e Bashkuar.	17.03.2014
18	Leonid Eduardovich SLUTSKI (Леонид Эдуардович СЛУЦКИЙ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 4.1.1968 Vendi i lindjes: Moskë, Federata Ruse	Ish Kryetar i Komitetit të Komonuelthit të Shteteve të Pavarura (CIS) të Dumës Shtetërore të Federatës Ruse (anëtar i LDPR). Ai mbështeti në mënyrë aktive përdorimin e Forcave të Armatosura Ruse në Ukrainë dhe aneksimin e Krimesë. Aktualisht kryetar i Komitetit të Punëve të Jashtme të Dumës Shtetërore të Federatës Ruse	17.03.2014
19	Aleksandr Vikto- rovich VITKO (Александр Викторович ВИТКО)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 13.9.1961 Vendi i lindjes: Vitebsk (RSS e Belorusisë), tani Belorusi	Ish komandanti i Flotës së Detit të Zi, Admiral. Përgjegjës për komandimin e forcave ruse që kanë pushtuar territorin sovran të Ukrainës. Shefi i Shtabit dhe Zëvendës Komandanti i Parë i Përgjithshëm i Marinës Ruse	17.03.2014
20	Anatoliy Aleksееvich SIDOROV (Анатолий Алексеевич СИДОРОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 2.7.1958 Vendi i lindjes: rajoni Siva, Perm, BRSS (Federata Ruse)	Ish komandant i Qarkut Ushtarak Perëndimor të Rusisë, njësitë e të cilit janë dislokuar në Krime. Ai ishte përgjegjës për një pjesë të pranisë ushtarake ruse në Krime, e cila po minon sovranitetin e Ukrainës dhe ndihmoi autoritetet e Krimesë në parandalimin e demonstratave publike kundër lëvizjeve drejt një referendumi dhe inkuorporimit në Rusi. Që nga nëntori i vitit 2015, ai është Shef i Shtabit të Përbashkët të Organizatës së Traktatit të Sigurisë Kolektive (CSTO).	17.03.2014
21	Aleksandr Vikto-	Gjinia: Mashkull	Ish-komandant i Qarkut Ushtarak Jugor të	17.03.2014

	rovich GALKIN (Александр Викторович ГАЛКИН)	Data e Lindjes: 22.3.1958 Vendi i lindjes: Ordzhonikidze (Vladikavkaz), RSS Autonome e Osetisë së Veriut, BRSS (tani Federata Ruse)	Rusisë ('SMD'), forcat e të cilit ndodhen në Krime; Flota e Detit të Zi vjen nën komandën e Galkinit; pjesa më e madhe e lëvizjes së forcës në Krime ka ardhur përmes SMD. Forcat e SMD-së janë vendosur në Krime. Ai është përgjegjës për një pjesë të pranisë ushtarake ruse në Krime, e cila po minon sovranitetin e Ukrainës dhe ka ndihmuar autoritetet e Krimesë në parandalimin e demonstratave publike kundër lëvizjeve drejt një referendumi dhe inkorporimit në Rusi. Përveç kësaj, Flota e Detit të Zi bie nën kontrollin e Distriktit. Aktualisht i punësuar në aparatën qendror të Ministrisë së Mbrojtjes Ruse. Ndhmës i Ministrit të Mbrojtjes që nga data 19 janar 2017.	
22	Dmitry Olegovich ROGOZIN (Дмитрий Олегович РОГОЗИН)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 21.12.1963 Vendi i lindjes: Moskë, Federata Ruse	Ish zëvendëskryeministër i Federatës Ruse. Ai bëri thirrje publike për aneksimin e Krimesë. Që nga viti 2018 mban pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm në një korporatë shtetërore.	21.3.2014
23	Sergey Yurievich GLAZYEV (Сергей Юрьевич ГЛАЗЬЕВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 1.1.1961 Vendi i lindjes: Zaporozhye, (RSS e Ukrainës), tani Ukraina	Ish këshilltar i Presidentit të Federatës Ruse. Ai bëri thirrje publike për aneksimin e Krimesë. Që nga tetori i vitit 2019, ai është ministër për Integrim dhe Makroekonominë në Komisionin Ekonomik Euroaziatik.	21.3.2014
24	Valentina Ivanova MATVIYENKO (born TYUTINA) (Валентина Ивановна МАТВИЕНКО (born ТЮТИНА))	Gjinia: Femër Data e Lindjes: 7.4.1949 Vendi i lindjes: Shepetovka, rajoni Khmeltsky (KamenetsPodolsky) (RSS e Ukrainës), tani Ukraina	Kryetare e Këshillit të Federatës. Më 1 mars 2014, mbështeti publikisht, në Këshillin e Federatës, vendosjen e forcave ruse në Ukrainë.	21.3.2014
25	Sergei Evgenevich NARYSHKIN (Сергей Евгеньевич)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 27.10.1954 Vendi i lindjes:	Ish-kryetar i Dumës shtetërore. Mbështeti publikisht vendosjen e forcave ruse në Ukrainë. Mbështeti publikisht traktatin e ribashkimit Rusi-Krime dhe ligjin kushtetues federal	21.3.2014

	НАРЫШКИН)	Shën Petersburg (ish Leningrad), Federata Ruse	përkatës. Aktualisht, ai është Drejtor i Shërbimit të Inteligjencës së Jashtme të Federatës Ruse që nga tetori i vitit 2016. Ai është anëtar i përhershëm dhe Sekretar i Këshillit të Sigurimit të Federatës Ruse	
26	Dmitry Konstantinovich KISELYOV Dmitrii Konstantinovich KISELEV (Дмитрий Константинович КИСЕЛЁВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 26.4.1954 Vendi i lindjes: Moskë, Federata Ruse	Më 9 dhjetor 2013, emërohet me Dekret Presidencial si Drejtues i agjencisë së lajmeve të Shtetit Federal Rus "Rossiya Segodnya". Figura qendrore e propagandës qeveritare që mbështet dislokimin e forcave ruse në Ukrainë	21.3.2014
27	Alexander Mihailovich NOSATOV (Александр Михайлович НОСАТОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 27.3.1963 Vendi i lindjes: Sevastopol, (RSS e Ukrainës), Ukrainë	Ish zëvendës-komandant i Flotës së Detit të Zi, Kundëradmiral. Përgjegjës për komandimin e forcave ruse që kanë pushtuar territorin sovran të Ukrainës. Aktualisht Admiral, Komandant i Flotës Ruse të Balltikut.	21.3.2014
28	Valery Vladimirovich KULIKOV (Валерий Владимирович КУЛИКОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 1.9.1956 Vendi i lindjes: Zaporozhye, RSS e Ukrainës, tani Ukraina	Ish-Zëvendëskomandant i Flotës së Detit të Zi, Kundëradmiral. Përgjegjës për komandimin e forcave ruse që kanë pushtuar territorin sovran të Ukrainës. Më 26 shtator 2017, me dekret të Presidentit të Federatës Ruse, ai u shkarkua nga ky post dhe nga shërbimi ushtarak. Ish anëtar i Këshillit të Federatës së Federatës Ruse, që përfaqëson qytetin e aneksuar të Sevastopolit. Aktualisht shërben si deputet në 'Asamblenë Legjislative' të qytetit të Sevastopolit.	21.3.2014
29	Vladislav Yurievich SURKOV (Владислав Юрьевич СУРКОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 21.9.1964 Vendi i lindjes: Solntsevo, rajoni Lipetsk, Federata Ruse	Ish ndihmës i Presidentit të Federatës Ruse. Ai ishte një organizator i procesit në Krime me të cilin komunitetet lokale të Krimesë u mobilizuan për të organizuar veprime që minonin autoritetet ukrainase në Krime. Mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste.	21.3.2014
30	Mikhail Grigorievich MALYSHEV	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 10.10.1955	Kryetar i Komisionit Zgjedhor të Krimesë. Përgjegjës për administrimin e 'referendimit' të Krimesë. Përgjegjës sipas sistemit rus për	21.3.2014

	(Михаил Григорьевич МАЛЫШЕВ) Мукхайло Нрыхович МАЛЫШЕВ (Михайло Григорович МАЛИШЕВ)	Vendi i lindjes: Simferopol, Krime, Ukrainë	nënshkrimin e rezultateve të referendumit. Në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Zgjedhor të Krimesë, ai mori pjesë në organizimin e zgjedhjeve presidenciale ruse të datës 18 mars 2018 dhe në zgjedhjet rajonale dhe lokale të datës 8 shtator 2019 në Krimenë dhe Sevastopolin e aneksuar ilegalisht, dhe në këtë mënyrë mbështeti dhe zbatoi në mënyrë aktive politikat që minojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.	
31			Personat e mëposhtëm janë fshirë nga lista e përcaktuar në Shtojcën e Vendimit 2014/145/CFSP	
32	Lt. Gen. Igor Nikolaevich (Миколайович) TURCHENYUK (Игорь Николаевич ТУРЧЕНЮК)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 5.12.1959 Vendi i lindjes: Osh, RSS Kirgiz, tani Kirgistan	Ish komandanti de facto i trupave ruse të dislokuar në terren në Krimenë e aneksuar ilegalisht (të cilave Rusia vazhdon t'i referohet zyrtarisht si 'milicite lokale të vetëmbrojtjes'). Ish zëvendës komandant i Qarkut Ushtarak Jugor. Aktualisht është shef i Departamentit të Administratës Publike dhe Sigurisë Kombëtare në Akademinë Ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm Rus.	21.3.2014
33	Elena Borisovna MIZULINA (born ДМИТРИЕВА) (Елена Борисовна МИЗУЛИНА (born ДМИТРИЕВА))	Gjinia: Femër Data e Lindjes: 9.12.1954 Vendi i lindjes: Bui, rajoni Kostroma, Federata Ruse	Ish-deputete në Dumën e Shtetit. Origjinatore dhe bashkëspansore e propozimeve të fundit legjislative në Rusi që do të kishin lejuar rajone të vendeve të tjera të bashkoheshin me Rusinë pa marrëveshjen paraprake të autoriteteve të tyre qendrore. Që nga shtatori i vitit 2015, anëtare e Këshillit të Federatës nga rajoni Omsk. Aktualisht Zëvendëskryetare e Komitetit të Këshillit të Federatës për Legjislacionin Kushtetues dhe shtetndërtimin	21.3.2014
34	Dmitry Nikolayevich KOZAK (Дмитрий Николаевич КОЗАК)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 7.11.1958 Vendi i lindjes: Bandurovo, rajoni Kirovograd, RSS e Ukrainës, tani Ukrainë	Ish-zëvendëskryeministër. Përgjegjës për mbikëqyrjen e integritetit të 'Republikës Autonome të Krimesë', të aneksuar në Federatën Ruse. Zëvendës Shef i Shtabit të Administratës Presidenciale të Federatës Ruse. Ai është i dërguari special i Presidentit për menaxhimin e konfliktit në Ukrainë.	29.4.2014

		Nationaliteti: Rus		
35	Oleg Yevgenyovich BELAVENTSEV (Олег Евгеньевич БЕЛАВЕНЦЕВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 15.9.1949 Vendi i lindjes: Moskë ose rajoni Ostrov, Pskov, Federata Ruse	Ish Përfaqësues Fuqplotë i Presidentit të Federatës Ruse në të ashtuquajturin "Rrethin Federal të Krimesë", përgjegjës për zbatimin e prerogativave kushtetuese të kreut të shtetit rus në territorin e 'Republikës Autonome të aneksuar të Krimesë'. Ish-anëtar jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të Rosisë. Ish Përfaqësues Fuqplotë i Presidentit të Federatës Ruse në Qarkun Federal të Kaukazit të Veriut (deri në qershor të vitit 2018). Mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste. Konsull Nderi i Nikaraguas në Krime që nga tetori i vitit 2020.	29.4.2014
36	Oleg Genrikhovich SAVELYEV (Олег Генрихович САВЕЛЪЕВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 27.10.1965 Vendi i lindjes: Leningrad, Bashkimi Sovjetik (tani Shën Petersburg, Federata Ruse)	Ish-ministri për Çështjet e Krimesë. Përgjegjës për integrimin e 'Republikës Autonome të Krimesë', të aneksuar në Federatën Ruse. Ish Zëvendës Shef i Shtabit të Qeverisë Ruse, përgjegjës për organizimin e punës së Komisionit Qeveritar për zhvillimin socio-ekonomik të të ashtuquajturës 'Republikës së Krimesë'. Ish Shef i Shtabit të Dhomës së Llogarive të Federatës Ruse. Që nga shtatori i vitit 2019, ai është Auditor i Dhomës së Llogarive të Federatës Ruse.	29.4.2014
37	Sergei Ivanovich MENYAILO (Сергей Иванович МЕНЯЙЛО)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 22.8.1960 Vendi i lindjes: Alagir, RSS Autonome e Osetisë së Veriut, Republika Socialiste Federative Sovjetike Ruse (tani Federata Ruse)	Ish-guvernatori i qytetit të aneksuar ukrainas të Sevastopolit. Ish Përfaqësues Fuqplotë i Presidentit të Federatës Ruse në Rrethin Federal të Siberisë. Anëtar i Këshillit të Sigurimit të Federatës Ruse. Ushtuesi i detyrës së kreut të Osetisë së Veriut që nga 9 prilli i vitit 2021.	29.4.2014
38	Olga Fedorovna KOVITIDI (Ольга Фёдоровна	Gjinia: Femër Data e Lindjes: 7.5.1962 Vendi i lindjes:	Anëtare e Këshillit të Federatës Ruse nga "Republika Autonome e Krimesë" e aneksuar që nga viti 2014, e riemëruar në vitin 2019.	29.4.2014

	КОВИТИДИ)	Simferopol, RSS e Ukrainës (tani Ukraina)		
39 ▼M13	VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2015/432 datë 13 mars 2015		Personat e mëposhtëm janë fshirë nga lista e përcaktuar në Shtojcën e Vendimit 2014/145/CFSP	
40	Sergei Ivanovich NEVEROV (Сергей Иванович НЕВЕРОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 21.12.1961 Vendi i lindjes: Tashtagol, BRSS (tani Federata Ruse)	Ish-zëvendëskryetar i Dumës shtetërore. Përgjegjës për iniciimin e legjislacionit për integrimin e 'Republikës Autonome të Krimesë', të aneksuar në Federatën Ruse. Anëtar i Dumës, kreu i fraksionit Rusia e Bashkuar.	29.4.2014
41 ▼M15	VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2016/359 datë 10 mars 2016		Personat e mëposhtëm janë fshirë nga lista e përcaktuar në Shtojcën e Vendimit 2014/145/CFSP	
42	Valery Vasilevich GERASIMOV (Валерий Васильевич ГЕРАСИМОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 8.9.1955 Vendi i lindjes: Kazan, Federata Ruse	Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Federatës Ruse, Zëvendësministër i Parë i Mbrotjtjes i Federatës Ruse, Gjeneral i Ushtrisë. Përgjegjës për vendosjen masive të trupave ruse përgjatë kufirit me Ukrainën dhe mungesën e depërshkallëzimit të situatës.	29.4.2014
43	German PROKOPIV (Герман ПРОКОПИВ) Herman PROKOPIV (Герман ПРОКОПИВ) (a.k.a. Li Van Chol, Ли Ван Чоль)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 6.7.1993 ose 6.7.1991 Vendi i lindjes: Pragë, Republika e Çekisë	Anëtar aktiv i "Gardës së Luhanskut". Mori pjesë në sekuestrimin e ndërtesës së zyrës rajonale të Shërbimit të Sigurisë në Luhansk. Mbetet luftëtar aktiv ushtarak i LNR-së.	29.4.2014
44 ▼M21	VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2017/1561 datë 14		Personat e mëposhtëm janë fshirë nga lista e përcaktuar në Shtojcën e Vendimit 2014/145/CFSP	

	shtator 2017			
45	<p>Andrei Evgenevich PURGIN (Андрей Евгеньевич ПУРГИН) Andriy Yevhenovych PURHIN (Андрій Євгенович ПУРГІН)</p>	<p>Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 26.1.1972 Vendi i lindjes: Donetsk, Ukrainë</p>	<p>Pjesëmarrës aktiv dhe organizator i aksioneve separatiste, koordinator i veprimeve të 'turistëve rusë' në Donetsk. Bashkëthemelues i 'Nismës Qytetare të Donbasit për Bashkimin Euroaziatik'. Ish-'Zëvendëskryetari i Parë i Këshillit të Ministrave'. Deri më 4 shtator 2015, ai ishte 'Kryetar' i 'Këshillit Popullor të Republikës Popullore të Donetskut'. Që nga shkurti i vitit 2017, ai u privua nga mandati i anëtarit të 'Këshillit Popullor të Republikës Popullore të Donetskut' me vendim të të ashtuquajturit 'Këshilli Popullor'. Mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste.</p>	29.4.2014
46	<p>Denys Volodymyrovych PUSHYLIN (Денис Володимирович ПУШИЛІН) Denis Vladimirovich PUSHILIN (Денис Владимирович ПУШИЛИН)</p>	<p>Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 9.5.1981 Vendi i lindjes: Makiivka (rajoni i Donetsk), Ukrainë</p>	<p>Një nga udhëheqësit e 'Republikës Popullore të Donetskut'. Mori pjesë në kapjen dhe pushtimin e administratës rajonale në Donetsk në vitin 2014. Deri më 4 shtator 2015, i ashtuquajturit Zëvendëskryetar i 'Këshillit Popullor' të të ashtuquajturës 'Republika Popullore e Donetskut'. Që nga data 4 shtator 2015 'Kryetar' i 'Këshillit Popullor të Republikës Popullore të Donetskut'. I ashtuquajturit 'ushtrues detyre i kreut të Republikës Popullore të Donetskut' pas datës 7 shtator 2018. I ashtuquajturit 'Kreu i Republikës Popullore të Donetskut' pas të ashtuquajturave zgjedhje të 11 nëntorit 2018.</p>	29.4.2014
47	<p>Sergey Gennadevich TSYPLAKOV (Сергей Геннадьевич ЦЫПЛАКОВ) Serhiy Hennadiyovych TSYPLAKOV (Сергій Геннадійович ЦИПЛАКОВ)</p>	<p>Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 1.5.1983 Vendi i lindjes: Khartsyzsk, rajoni Donetsk, Ukrainë</p>	<p>Një nga drejtuesit e organizatës ideologjike radikale "Milicia Popullore e Donbasit". Ai mori pjesë aktive në sekuestrimin e një numri ndërtesash shtetërore në rajonin e Donetskut. Ish-anëtar i 'Këshillit Popullor të Republikës Popullore të Donetskut' dhe i Komitetit të tij për Politikën e Jashtme, Marrëdhëniet me Jashtë, Politikën e Informacionit dhe Teknologjinë e Informacionit.</p>	29.4.2014
48	Igor Vsevolodovich GIRKIN	<p>Gjinia: Mashkull Data e Lindjes:</p>	<p>Ai identifikohet si staf i Drejtorisë kryesore të Inteligjencës së Shtabit të Përgjithshëm të</p>	29.4.2014

	(Игорь Всеволодович ГИРКИН) (a.k.a. Igor STRELKOV, Ihor STRIELKOV	17.12.1970 Vendi i lindjes: Moskë, Federata Ruse	Forcave të Armatosura të Federatës Ruse (GRU). Ai ishte i përfshirë në incidentet në Sloviansk. Ai është kreu i lëvizjes publike "Novorossia". Ish 'Ministër i Mbrojtjes' i të ashtuquajturës 'Republika Popullore e Donetskut'. Më 4 nëntor 2016, ai organizoi një marsh rus në Moskë për nacionalistët rusë që mbështesin separatistët në Ukrainën lindore. Mbetet aktiv në mbështetjen e aktivitetit separatist në Ukrainën lindore.	
49	Vyacheslav Viktorovich VOLODIN (Вячеслав Викторович ВОЛОДИН	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 4.2.1964 Vendi i lindjes: Alekseevka, rajoni Saratov, Federata Ruse	Ish Zëvendës Shefi i Parë i Shtabit të Administratës Presidenciale të Rosisë. Përgjegjës për mbikëqyrjen e integritetit politik të rajonit ukrainas të Krimesë, të aneksuar në Federatën Ruse. Aktualisht, ai është kryetar i Dumës Shtetërore të Federatës Ruse që nga data 5 tetor 2016	12.5.2014
50	Vladimir Anatolievich SHAMANOV (Владимир Анатольевич ШАМАНОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 15.2.1957 Vendi i lindjes: Barnaul, Federata Ruse	Ish komandant i trupave ajrore ruse, gjeneral kolonel. Në pozitën e tij të lartë, ai mban përgjegjësi për vendosjen e forcave ajrore ruse në Krime. Aktualisht, ai është kryetar i Komitetit të Mbrojtjes të Dumës Shtetërore të Federatës Ruse.	12.5.2014
51	Vladimir Nikolaevich PLIGIN (Владимир Николаевич ПЛИГИН)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 19.5.1960 Vendi i lindjes: Ignatovo, Rajoni Vologodsk , Bashkimi Sovjetik (tani Federata Ruse)	Ish-anëtar i Dumës shtetërore dhe ish Kryetar i Komitetit të Ligjit Kushtetues të Dumës. Përgjegjës për lehtësimin e miratimit të legjislacionit për aneksimin e Krimesë dhe Sevastopolit në Federatën Ruse. Ish-anëtar i Këshillit Suprem të partisë Rusia e Bashkuar. Këshilltar i Kryetarit të Dumës, Volodin. Aktualisht studiues në Institutin e Shtetit dhe Ligjit në Akademinë e Shkencave Ruse. Bashkëkryetar i Shoqatës së Avokatëve Rus.	12.5.2014
52	Petr Grigorievich JAROSH (Петр	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 30.1.1971	Ish-kreu i zyrës së Shërbimit Federal të Migracionit për Krimenë. Përgjegjës për lëshimin sistematik dhe të përsheptuar të	12.5.2014

	Григорьевич ЯРОШ) Petro Hryhorovych YAROSH (IAROSH) (Петро Григорович ЯРОШ)	Vendi i lindjes: Fshati Skvortsovo, Rajoni Simferopol, Krime, Ukrainë	pasaportave ruse për banorët e Krimesë.	
53	Oleg Grigorievich KOZYURA (Олег Григорьевич КОЗЮРА) Oleh Hryhorovych KOZYURA (Олег Григорович КОЗЮРА)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 30.12.1965 ose 19.12.1962 Vendi i lindjes: Simferopol, Krime ose Zaporizhia, Ukrainë	Ish shef i zyrës së Shërbimit Federal të Migracionit për Sevastopol. Përgjegjës për lëshimin sistematik dhe të përsheptuar të pasaportave ruse për banorët e Sevastopolit. Ish Shefi i Shtabit të Asamblesë Legjislative të Sevastopolit. Këshilltar i Guvernatorit të Sevastopolit.	12.5.2014
54	Viacheslav PONO- MARIOV Vyacheslav Volodymyrovich PONOMARYOV (В'ячеслав Володимирович ПОНОМАРЬОВ) Viacheslav Vladimi-rovich PONOMAREV (Вячеслав Владимирович ПОНОМАРЁВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 2.5.1965 Vendi i lindjes: Sloviansk (Rajoni Donetsk), Ukrainë	Ish 'Kryetari Popullor' i vetëshpallur i Slovianskut (deri më 10 qershor 2014). Ponomariov i bëri thirrje Vladimir Putinit të dërgonte trupa ruse për të mbrojtur qytetin dhe më vonë i kërkoi atij të furnizonte me armë. Njerëzit e Ponomariov ishin të përfshirë në rrëmbime (ata kapën aktivisten Irma Krat dhe Simon Ostrovsky, reporter për Vice News, të dy u liruan më vonë, ata arrestuan vëzhgues ushtarakë sipas Dokumentit të OSBE-së të Vjenës). Ai mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste.	12.5.2014
55	Igor Nikolaevich BEZLER (a.k.a. Bes(devil)) (Игорь Николаевич БЕЗЛЕР) Ihor Mykolayovych BEZLER (Ігор Миколайович БЕЗЛЕР) a.k.a. Igor Nikolaevich	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 30.12.1965 Vendi i lindjes: Simferopol, Krime, Ukrainë	Një nga ish-udhëheqësit e vetëshpallur të milicisë së Horlivka. Ai mori kontrollin e Shërbimit të Sigurimit të Zyrës së Ukrainës në ndërtesën e rajonit Donetsk dhe më pas pushtoi stacionin e qarkut të Ministrisë së Punëve të Brendshme në qytetin Horlivka. Ai ka lidhje me Igor Strelkov/Girkin nën komandën e të cilit ai ishte i përfshirë në vrasjen e deputetit të popullit të Këshillit Bashkiak të Horlivkës, Volodymyr Rybak. Mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave	12.5.2014

	BEREGOVOY (Игорь Николаевич БЕРЕГОВОЙ)		separatiste.	
56	Igor Evgenevich КАКИДЗЯНОВ (Игорь Евгеньевич КАКИДЗЯНОВ) Igor Evgenevich КНАКИМЗЯНО V (Игорь Евгеньевич ХАКИМЗЯНОВ) Ihor Yevhenovych КНАКИМЗИАНОВ (КАКИДЗИАНОВ) (Игорь Евгенович ХАКИМЗЯНОВ (КАКИДЗЯНОВ))	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 25.7.1980 Vendi i lindjes: Makiivka (Rajoni Donetsk), Ukrainë	Një nga ish-udhëheqësit e forcave të armatosura të 'Republikës së vetëshpallur Popullore të Donetskut'. Qëllimi i forcave është 'të mbrojnë popullin e Republikës Popullore të Donetskut dhe integritetin territorial të republikës', sipas Pushylin, një nga udhëheqësit e 'Republikës Popullore të Donetskut'. Mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste.	12.5.2014
57	Oleg TSARIOV, Oleh Anatoliyovych TSAROV (Олег Анатолійович ЦАРЬОВ) Oleg Anatolevich TSARYOV (Олег Анатольевич ЦАРЁВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 2.6.1970 Vendi i lindjes: Dnepropetrovsk (tani Dnipro), Ukrainë	Ish-deputeti i Radës, si i tillë publikisht bëri thirrje për krijimin e të ashtuquajturës 'Republikës Federale të Novorossiya', e përbërë nga rajonet juglindore të Ukrainës. Ish 'Kryetar' i të ashtuquajturit 'Parlamenti i Unionit të Republikave Popullore' ('Parlamenti i Novorossiya'). Ai mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste.	12.5.2014
58	Roman Viktorovich LYAGIN (Роман Викторович ЛЯГИН) Roman Viktorovych LIAHIN (Роман Вікторович ЛЯГИН)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 30.5.1980 Vendi i lindjes: Donetsk, Ukrainë	Ish-kreu i Komisionit Qendror Zgjedhor "Republika Popullore e Donetskut". Ai organizoi në mënyrë aktive referendumin e datës 11 maj 2014 për vetëvendosjen e "Republikës Popullore të Donetskut". Ish "Ministri i Punës dhe Politikës Sociale". I nënshtrohet procedurave penale në Ukrainë.	12.5.2014
59	Aleksandr Sergeevich MALYKHIN Alexander	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 12.1.1981	Ish-kreu i Komisionit Qendror Zgjedhor të "Republikës Popullore të Luhanskut". Ai organizoi në mënyrë aktive referendumin e	12.5.2014

	<p>Sergeevich MALYHIN (Александр Сергеевич МАЛЫХИН) Oleksandr Serhiyovych (Sergiyovych) MALYKHIN (Олександр Сергійович МАЛИХІН)</p>		<p>datës 11 maj 2014 për vetëvendosjen e ‘Republikës Popullore të Luhanskut’. Ai mbetet aktiv në mbështetjen e politikave separatiste.</p>	
60	<p>Natalia Vladimirovna POKLONSKAYA (Наталья Владимировна ПОКЛОНСКАЯ)</p>	<p>Data e Lindjes: 18.3.1980 Vendi i lindjes: Mikhailovka, Rajoni Voroshilovgrad, RSS e Ukrainës ose Yevpatoria, RSS e Ukrainës (tani Ukraina)</p>	<p>Anëtar i Dumës Shtetërore, i zgjedhur nga ‘Republika autonome e Krimesë’ e aneksuar ilegalisht. Ish-prokuror i të ashtuquajturës ‘Republika e Krimesë’. Zbatoi në mënyrë aktive aneksimin e Krimesë nga Rusia. Aktualisht nënkryetar i Komisionit për Çështjet Ndërkombëtare, anëtar i Komisionit për hetimin e ndërhyrjeve të huaja në punët e brendshme të Federatës Ruse, anëtar i Komitetit për Siguri dhe Kundër Korrupsionit të Dumës Shtetërore të Federatës Ruse.</p>	12.5.2014
61	<p>Igor Sergeievich SHEVCHENKO (Игорь Сергеевич ШЕВЧЕНКО)</p>	<p>Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 9.2.1979 Vendi i lindjes: Sevastopol, Krime, Ukrainë</p>	<p>Ish-prokuror i Sevastopolit dhe si i tillë aktiv në zbatimin e aneksimin të Sevastopolit nga Rusia. Prokurori i Republikës së Adygeas.</p>	12.5.2014
62	<p>Aleksandr Yurevich BORODAI (АлександрЮрьевич БОРОДАЙ)</p>	<p>Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 25.7.1972 Vendi i lindjes: Moskë, Federata Ruse</p>	<p>Ish- i ashtuquajturi ‘Kryeministri i Republikës Popullore të Donetskut’, si i tillë përgjegjës për aktivitetet ‘qeveritare’ separatiste të të ashtuquajturës ‘qeveria e Republikës Popullore të Donetskut’ (p.sh. më 8 korrik 2014 deklaroi “ushtria jonë po kryen një operacioni special kundër ‘fashistëve’ ukrainas), nënshkrues i Memorandumit të Mirëkuptimit për ‘Unionin Novorossiya’. Mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste; kryeson ‘Unionin e vullnetarëve të Donbasit’. Kryetar i Bordit të Unionit të Vullnetarëve të Donbass. I përfshirë në mënyrë aktive në rekrutimin dhe trajnimin e ‘vullnetarëve’ të dërguar për të</p>	12.7.2014

			luftuar në Donbas.	
63	<p>Alexander KHODA-KOVSKY Oleksandr Serhiyovych KHODAKOVSKYY (KHODAKOVSKYI) (Олександр Сергійович ХОДАКОВСЬКИЙ ) Aleksandr Sergeevich KHODAKOVSKII (Александр Сергеевич ХОДАКОВСКИЙ)</p>	<p>Gjinia: Mashkull: Data e Lindjes: 18.12.1972 Vendi i lindjes: Donetsk, Ukrainë</p>	<p>Ish-i ashtuquajturi ‘Ministër i Sigurisë së Republikës Popullore të Donetskut’, si i tillë përgjegjës për aktivitetet separatiste të sigurisë të të ashtuquajturës ‘qeveria e Republikës Popullore të Donetskut’. Mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste.</p>	12.7.2014
64	<p>Alexandr Arka- dievich KALYUSSKY (Александр Аркадьевич КАЛЮССКИЙ) Oleksandr Arka- diyovych KALYUSSKIY (Олександр Аркадійович КАЛЮСЬКИЙ)</p>	<p>Gjinia: Mashkull: Data e Lindjes: 9.10.1975</p>	<p>Ish i ashtuquajturi ‘de fakto zëvendëskryeministër për çështjet sociale të Republikës Popullore të Donetskut’. Përgjegjës për aktivitetet ‘qeveritare’ separatiste të të ashtuquajturës ‘qeveria e Republikës Popullore të Donetskut’.</p>	12.7.2014
65	<p>Alexander KHRYAKOV Aleksandr Vitalievich KHRYAKOV (Александр Витальевич ХРЯКОВ) Oleksandr Vita- liyovych KHRYAKOV (Олександр Віталійович ХРЯКОВ)</p>	<p>Gjinia: Mashkull: Data e Lindjes: 6.11.1958 Vendi i lindjes: Donetsk, Ukrainë</p>	<p>Ish i ashtuquajturi ‘ministër i informacionit dhe komunikimit masiv’ i ‘Republikës Popullore të Donetskut’. Aktualisht është anëtar i të ashtuquajturit ‘Këshillit Popullor’ të ‘Republikës Popullore të Donetskut’. Përgjegjës për aktivitetet e propagandës pro-separatiste të të ashtuquajturës ‘qeveria’ e ‘Republikës Popullore të Donetskut’. Vazhdon mbështetjen aktive për veprimet separatiste në Ukrainën Lindore.</p>	12.7.2014

66	Marat Faatovich BASHIROV (Марат Фаатович БАШИРОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 20.1.1964 Vendi i lindjes: Izhevsk, Federata Ruse	Ish-i ashtuquajturi 'Kryeministri i Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Luhanskut', i konfirmuar më 8 korrik 2014. Përgjegjës për aktivitetet 'qeveritare' separatiste të të ashtuquajturës 'qeveria e Republikës Popullore të Luhanskut'. Vazhdon aktivitetet e mbështetjes së strukturave separatiste të LNR-së.	12.7.2014
67	Vasyl Oleks- androvych NIKITIN (Василь Олек- сандрович НИКИТИН) Vasilii Aleks- androvich NIKITIN (Василий Алек- сандрович НИКИТИН)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 25.11.1971 Vendi i lindjes: Shargun, Uzbekistan	Ish i ashtuquajturi 'Zëvendëskryeministër i Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Luhanskut' (dikur ishte i ashtuquajturi 'Kryeministri i Republikës Popullore të Luhanskut' dhe ish-zëdhënës i 'Ushtrisë së Juglindjes'). Përgjegjës për aktivitetet 'qeveritare' separatiste të të ashtuquajturës 'qeveria e Republikës Popullore të Luhanskut'. Përgjegjës për deklaratën e Ushtrisë Juglindore se zgjedhjet presidenciale të Ukrainës në 'Republikën Popullore të Luhanskut' nuk mund të zhvillohen për shkak të statusit 'të ri' të rajonit. Mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste.	12.7.2014
68	Aleksey Vyachesla- vovich KARYAKIN (Алексей Вячеславович КАРЯКИН) Oleksiy Vyachesla- vovych KARYAKIN (Олексій В'ячеславович КАРЯКИН)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 7.4.1980 ose 7.4.1979 Vendi i lindjes: Stakhanov, rajoni Luhansk, Ukrainë	Deri më 25 mars 2016, ishte i ashtuquajturi 'Kryetar i Këshillit Suprem të Republikës Popullore të Luhanskut', përgjegjës për aktivitetet 'qeveritare' separatiste të 'Këshillit Suprem', përgjegjës për t'i kërkuar Federatës Ruse të njohë pavarësinë e 'Republikës Popullore të Luhanskut'. Nënshkrues i Memorandumit të Mirëkuptimit për 'unionin e Novorossiya'. Ish-anëtar i të ashtuquajturit 'Këshilli Popullor i Republikës Popullore të Luhanskut'. Mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste. Aktualisht kryetar i të ashtuquajturës 'Oda Publike e Republikës Popullore të Luhanskut'.	12.7.2014
69	Yuriy Volodymy- rovych IVAKIN (Юрій Володимирович ІВАКІН) Iurii Vladimirovich	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 13.8.1954 Vendi i lindjes: Perevalsk (rajoni Luhansk), Ukrainë	Ish-i ashtuquajturi 'Ministër i Punëve të Brendshme të Republikës Popullore të Luhanskut', dhe si i tillë përgjegjës për aktivitetet 'qeveritare' separatiste të të ashtuquajturës 'qeveria e Republikës Popullore	12.7.2014

	ИВАКИН (Юрий Владимирович ИВАКИН)		të Luhanskut’.	
70	Igor PLOTNITSKY Igor Venediktovich PLOTNITSKIИ (Игорь Венедиктович ПЛОТНИЦКИЙ) Ihor (Igor) Venedyktovich PLOTNYTSKYU (Ігор Венедиктович ПЛОТНИЦЬКИЙ)	Gjinia: Mashkull: Data e Lindjes: 24.6.1964 ose 25.6.1964 ose 26.6.1964 Vendi i lindjes: Luhansk (ndoshta në Kelmentsi, rajoni Chernivtsi), Ukrainë	Ish i ashtuquajturi ‘ministër i mbrojtjes’ dhe ish i ashtuquajturi ‘kreu’ i ‘Republikës Popullore të Luhanskut’ dhe si i tillë përgjegjës për aktivitetet ‘qeveritare’ separatiste të të ashtuquajturës ‘qeveria e Republikës Popullore të Luhanskut’. Ish i dërguari special i të ashtuquajturës ‘Republika Popullore e Luhanskut’ për zbatimin e Minskut.	12.7.2014
71	Nikolay Ivanovich KOZITSYN (Николай Иванович КОЗИЦЫН)	Gjinia: Mashkull: Data e Lindjes: 20.6.1956 ose 6.10.1956 Vendi i lindjes: Djerzjinsk, rajoni Donetsk, Ukrainë	Komandant i forcave të Kozakëve. Përgjegjës për komandimin e separatistëve në Ukrainën Lindore që luftojnë kundër forcave të qeverisë ukrainase. Mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste.	12.7.2014
72	COUNCIL DECISION (CFSP) ▼M14 2015/1524 of 14 September 2015		Personat e mëposhtëm janë fshirë nga lista e përcaktuar në Shtojcën e Vendimit 2014/145/CFSP	
73	Mikhail Efimovich FRADKOV (Михаил Ефимович ФРАДКОВ)	Gjinia: Mashkull: Data e Lindjes: 1.9.1950 Vendi i lindjes: Kurumoch, rajoni Kuibyshev, Federata Ruse	Ish anëtar i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të Federatës Ruse; Ish-drejtor i Shërbimit të Inteligjencës së Jashtme të Federatës Ruse. Si anëtar i Këshillit të Sigurimit, që ofron këshilla dhe koordinon çështjet e sigurisë kombëtare, ai ishte i përfshirë në formësimin e politikës së qeverisë ruse që kërcënonte integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës. Që nga data 4 janar 2017, ai është Drejtor i Institutit Rus për Studime Strategjike. Ai është edhe Kryetar i Bordit Drejtues të ‘Almaz-Antey’. Mbetet aktiv në mbështetjen e veprimeve ose politikave separatiste.	25.7.2014
74	Nikolai Platonovich PATRUSHEV	Gjinia: Mashkull: Data e Lindjes: 11.7.1951	Anëtar i Përhershëm dhe Sekretar i Këshillit të Sigurimit të Federatës Ruse. Si anëtar i Këshillit të Sigurimit, që ofron këshilla dhe	25.7.2014

	(Николай Платонович ПАТРУШЕВ)	Vendi i lindjes: Leningrad, Bashkimi Sovjetik (Shën Petersburg, Federata Ruse)	koordinon çështjet e sigurisë kombëtare, ai ishte i përfshirë në formësimin e politikës së qeverisë ruse që kërcënonte integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.	
75	Aleksandr Vasilievich BORTNIKOV (Александр Васильевич БОРТНИКОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 15.11.1951 Vendi i lindjes: Perm, Federata Ruse	Anëtar i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të Federatës Ruse; Drejtori i Shërbimit Federal të Sigurisë (FSB). Si anëtar i Këshillit të Sigurimit, që ofron këshilla dhe koordinon çështjet e sigurisë kombëtare, ai ishte i përfshirë në formësimin e politikës së qeverisë ruse që kërcënonte integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.	25.7.2014
76	Rashid Gumarovich NURGALIEV (Рашид Гумарович НУРГАЛИЕВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 8.10.1956 Vendi i lindjes: Zhetikara, RSS Kazakh (tani Kazakistan)	Anëtar dhe Zëvendës Sekretar i Këshillit të Sigurimit të Federatës Ruse. Si anëtar i Këshillit të Sigurimit, që ofron këshilla dhe koordinon çështjet e sigurisë kombëtare, ai ishte i përfshirë në formësimin e politikës së qeverisë ruse që kërcënonte integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.	25.7.2014
77	Boris Vyacheslavovich GRYZLOV (Борис Вячеславович ГРЫЗЛОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 15.12.1950 Vendi i lindjes: Vladivostok, Federata Ruse	Ish anëtar i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të Federatës Ruse. Si anëtar i Këshillit të Sigurimit, që ofron këshilla dhe koordinon çështjet e sigurisë kombëtare, ai ishte i përfshirë në formësimin e politikës së qeverisë ruse që kërcënonte integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës. Ai mbetet kryetar i Këshillit Suprem të partisë Rusia e Bashkuar. Kryetar i Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes shtetërore Tactical Missiles Corporation JSC.	25.7.2014
78	Sergei Orestovich BESEDA (Сергей Орестович БЕСЕДА)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 17.5.1954	Komandant i Shërbimit të Pestë të FSB, Shërbimi Federal i Sigurisë i Federatës Ruse. Si oficer i lartë i FSB-së (Gjeneral Kolonel), ai drejton një shërbim përgjegjës për mbikëqyrjen e operacioneve të inteligjencës dhe aktivitetit ndërkombëtar.	25.7.2014
79	Mikhail Vladimirovich	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes:	Ish-deputet i Dumës shtetërore. Si anëtar i Dumës ai njoftoi përurimin e 'ambasadës de	25.7.2014

	DEGTYARYOV/ DEGTYAREV (Михаил Владимирович ДЕГТЯРЁВ)	10.7.1981 Vendi i lindjes: Kuibyshev (Samara), Federata Ruse	facto' të të panjohurës, të ashtuquajturës 'Republika Popullore e Donetskut' në Moskë. Ai kontribuon në minimin ose kërcënimin e integritetit territorial, sovranitetit dhe pavarësisë së Ukrainës. Ish-kryetar i Komitetit të Dumës Shtetërore Ruse për Edukimin Fizik, Sportin dhe Çështjet e Rinisë. Që nga data 20 korrik 2020, ushtrues detyre i guvernatorit të Khabarovsk Krai. Që nga data 6 shkurt 2021, Koordinator i degës rajonale të Partisë Liberal Demokratike të Rusisë.	
80	Ramzan Akhma- dovitch KADYROV (Рамзан Ахматович КАДЫРОВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 5.10.1976 Vendi i lindjes: Tsentaroy, Çeçeni, Federata Ruse	Presidenti i Republikës së Çeçenisë. Kadyrov bëri deklaratë në mbështetje të aneksimit të paligjshëm të Krimesë dhe në mbështetje të kryengritjes së armatosur në Ukrainë. Ai deklaroj, ndër të tjera, më 14 qershor 2014 se 'do të bëjë gjithçka për të ndihmuar në ringjalljen e Krimesë'. Në këtë kontekst, atij iu dha medalja për 'çlirimin e Krimesë' nga ushtruesi i detyrës së kreut të 'Republikës Autonome të Krimesë' për mbështetjen që i dha aneksimit të paligjshëm të Krimesë. Përveç kësaj, më datën 1 qershor 2014, ai shprehu gatishmërinë e tij për të dërguar 74 000 vullnetarë çeçenë në Ukrainë nëse i kërkohet një gjë e tillë.	25.7.2014
81	Alexander Niko- layevich TKACHYOV (Александр Николаевич ТКАЧЁВ)	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 23.12.1960 Vendi i lindjes: Vyselki, rajoni Krasnodar, Federata Ruse	Ish-guvernatori i Krasnodar Krai. Atij iu dha medalja 'për çlirimin e Krimesë' nga Ushtruesi i detyrës së kreut të 'Republikës Autonome të Krimesë' për mbështetjen që i dha aneksimit të paligjshëm të Krimesë. Me atë rast, ushtruesi i detyrës së kreut të 'Republikës Autonome të Krimesë' tha se Tkachyov ishte një nga të parët që shprehu mbështetjen e tij për 'udhëheqjen' e re të Krimesë. Ish-ministri i Bujqësisë i Federatës Ruse.	25.7.2014
82	Pavel Yurievich GUBAREV (Павел Юрьевич ГУБАРЕВ) Pavlo Yuriyovich	Gjinia: Mashkull Data e Lindjes: 10.2.1983 (ose 10.3.1983) Vendi i lindjes: Sievierodonetsk,	Një nga udhëheqësit e vetë-përshkruar të 'Republikës Popullore të Donetskut'. Ai kërkoi ndërhyrjen ruse në Ukrainën lindore, duke përfshirë vendosjen e forcave paqeruajtëse ruse. Ai ishte i lidhur me Igor Strelkov/Girkin, i cili është përgjegjës për veprimet që minojnë	25.7.2014

